



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 524/12 prot.

Datë 07.04.2025

V E N D I M
Nr. 450/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 377/2025, datë 18.03.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.

Ankimues: “MURATI D” SHPK, me NIPT (K42003004T), me adresë: “Rruga Kavajës”, Ish- Kombinati Ushqimor, Godinë 1- katëshe.

Operatori ekonomik “VASSA” SHPK, me Nipt K01421002H, Adresa: Lagjja: “Kryengritja e Fierit”, Fier.

“SAM-ARS 2016” SHPK, me NIPT (L62629204V), me adresë: Elbasan, Zona kadastrale N8526, Ndërtese nr. pasurisë 1327/27.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, me adresë: Rruga “11 Nëntori”, Elbasan.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit 2 Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 18/03/2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.377/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SAM-ARS 2016” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.*
2. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.*
3. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi dhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomikë “SAM-ARS 2016” Shpk.*
6. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kalimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “VASSA” Shpk dhe “Murati D” Shpk, në buxhetin e shtetit.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr. 214/4 prot., datë 01.04.2025, protokolluar me tonën nr. 524/9 prot., datë 03.04.2025, autoriteti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 377/2025, datë 18/03/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 214/4 prot., datë 01.04.2025, protokolluar me tonën nr. 524/9 prot., datë 03.04.2025, autoriteti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 377/2025, datë 18/03/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 214/4 prot., datë 01.04.2025, protokolluar me tonën nr. 524/9 prot., datë 03.04.2025, rezulton, se autoriteti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 377/2025, datë 18/03/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 377/2025, datë 18/03/2025, nga ku rezultoi, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e kësaj procedure, në zbatim të vendimit të Komisioni i Prokurimit Publik nr. 377/2025, datë 18/03/2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 377/2025, datë 18/03/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

